



**ALBANIAN THIRD POSITION**



**“Doktrina e Fashizmit”**

**Benito Mussolini | 1932**



**ALBANIAN THIRD POSITION**





# “Doktrina e Fashizmit”

nga Benito Mussolini

**-KUJTESË-**

Ky libër nuk duhet marrë si propagandë e fashizmit, por qëllim ka të njohim historinë dhe kontekstin politik se si u themelua dhe u përhap fashizmi nga Benito Musolini dhe këmishat e zeza. Lexuesi duhet të reflektojë dhe të nxjerrë mësim nga e shkuara.

Kjo është historia. Historia jonë dhe juaja, historia botërore.

Përktheu në SHQIP:

© ALBANIAN THIRD POSITION ©

-2021-





# ALBANIAN THIRD POSITION



## -Parathënie nga ATP-

“Doktrina e Fashizmit” nga Duçe është tani e disponueshme për lexuesit shqiptarë, fjalët e një njeriu të përcmuar gjatë gjithë kohës nga komunistët shqiptarë. Por ata që e përcmuan atë për zaptimin territorial të Shqipërisë harrojnë të përmendin se jo si sundimet e mëparshme, Italia Fashiste e Mussolini-t promovoi identitetin shqiptar, gjuhën shqiptare, historinë shqiptare dhe ribashkimin e Shqipërisë. Një sjellje e “çuditshme” për një pushtues te huaj. Gjithsesi, mënyra se si Fashizmi farkëtoi një komb, se si zhduku mafian dhe mjerimin (për të përmendur disa nga arritjet e tij) duhet të jetë në interesin tonë më të madh si shqiptarë. Me të vërtetë, Italia atëhere paraqiste shumë ngjashmëri me situatën e tanishme të atdheut tonë. Është me interes t’i hedhim një sy Fashizmit, edhe pse ne do ta kundërpeshonim me përshtypjet dhe komentet e Julius Evola-s për Fashizmin.

Përmes energjisë së tij, diturisë nga socializmi, dhe eksperiencës në vijën e parë të frontit, Mussolini e kuptoi rëndësinë e nocionit të atdheut për popullin. Jo si ëndërrimtarët me sy hapur internacionalistë, Mussolini e trupëzoi dhe ndërlidhi idenë e nacionalizmit të vështrimet e tij socialiste. Kjo do të ishte fara prej nga ku Fashizmi si doktrinë do të rritej dhe Italia do të ishte tokë perfekte për këtë. Duke thirrur dhe nxjerrë në pah simbolet e Perandorisë Romake, Mussolini korrektësisht e orientoi Italinë drejt arritjeve të mëdha dhe krijoi një identitet të pashkatërrueshëm italian. Ashtu si simboli i fashos (që përfaqëson unitetin), italianët nga rajone të ndryshme u bashkuan rreth së njejtës ide së Italisë trashëgimtare të Perandorisë Romake, duke mbrojtur të mirën e përbashkët e të gjithë italianëve detyra e të cilëve nuk ishte të kërkonin të verbuar interesat private të dëmshme për të mirën e përbashkët. Këto janë disa nga temat që Mussolini merret tek Doktrinën e Fashizmit. Pa dyshim, aplikimi historik i tyre ishte larg nga perfektja pasi Mussolini-t iu desh të bënte kompromis me klasën konservatore që përfaqësohej nga anëtarë të ndryshëm të aristokracisë italiane, si për shembull me Kontin Ciano, ose borgjezinë që e përqafonte fashizmin vetëm me oportunitet. Pavarësisht, arritje materiale, kulturore madje edhe arritje shpirtërore u bënë nën simbolin e fashos.

*(Ky artikull, i bashkë-shkruar nga Giovanni Gentile konsiderohet artikulimi më i plotë i pikëpamjeve politike të Musolinit. Ky është i vetmi përkthim i plotë zyrtar që njohim në internet, kopjuar direkt nga një botim zyrtar i qeverisë Fashiste i vitit 1935, Doktrina e Fashizmit dhe Institucionet, nga Benito Mussolini, Botuesit Ardita, Romë, faqet 7-42. Ky përkthim përfshin të gjitha fusnotat nga origjinali.)*

**S**i të gjitha konceptimet e shëndosha politike, Fashizmi është veprim dhe mendim; veprim në të cilin doktrina është imanente dhe doktrinë që buron nga një sistem i caktuar i forcave historike në të cilën është futur, dhe duke punuar mbi to nga brenda (1). Prandaj ka një formë të ndërlidhur me kontigjencat e kohës dhe hapësirës; por ka gjithashtu një përmbajtje ideale që e bën atë një shprehje të së vërtetës në sferat e larta të historisë së mendimit (2). Nuk ka asnjë mënyrë për të ushtruar një ndikim shpirtëror në botë si një vullnet njerëzor që dominon vullnetin e të tjerëve, përveç nëse dikush ka një konceptim të realitetit kalimtar dhe specifik mbi të cilin do të ushtrohet ai veprim, dhe të realitetit të përhershëm dhe universal në të cilën banon dhe ka qenien e tij kalimtare. Për të njohur burrat duhet njohur njeriun; dhe për të njohur njeriun duhet të njihesh me realitetin dhe ligjet e tij. Nuk mund të ketë koncept të Shtetit i cili nuk është thellësisht një koncept i jetës: filozofi apo intuitë, sistemi i ideve evoluon brenda kornizës së logjikës ose përqëndrohet në një vizion ose një besim, por gjithmonë, të paktën potencialisht, një konceptim organik i botës. Kështu që shumë prej shprehjeve praktike të Fashizmit siç janë organizimi i partisë, sistemi i arsimit dhe disiplina mund të kuptohen vetëm kur merren parasysh në lidhje me qëndrimin e tij të përgjithshëm ndaj jetës. Një qëndrim shpirtëror (3). Fashizmi sheh në botë jo vetëm ato aspekte sipërfaqësore, materiale në të cilat njeriu shfaqet si një individ, duke qëndruar i vetëm, egoist, subjekt i ligjit natyror, i cili nxitet instinktivisht drejt një jete me kënaqësi momentale egoiste; ai sheh jo vetëm individin, por kombin dhe vendin; individë dhe breza të lidhur së

bashku nga një ligj moral, me tradita të përbashkëta dhe një mision i cili duke shtypur instiktin për jetën e mbyllur në një rreth të shkurtër kënaqësie, ndërton një jetë më të lartë, me themele në detyrë, një jetë të lirë nga kufizimet e kohës dhe hapësirës, në të cilën individi, me vetëmohim, duke hequr dorë nga interesi vetjak, nga vetë vdekja, mund të arrijë atë ekzistencë të pastër shpirtërore, në të cilën konsiston vlera e tij si njeri.

Prandaj konceptimi është shpirtëror, që del nga reagimi i përgjithshëm qindvjeçar kundër pozitivizmit materialist të shekullit XIX. Anti-pozitivist, por pozitiv; as skeptik dhe as agnostik; as pesimist dhe as optimist siç janë, në përgjithësi, doktrinat (të gjitha negative) që vendosin qendrën e jetës jashtë njeriut; ndërsa, duke ushtruar vullnetin e tij të lirë, njeriu mund dhe duhet të krijojë botën e tij.

Fashizmi dëshiron që njeriu të jetë aktiv dhe të angazhohet në veprim me të gjitha energjitë e tij; dëshiron që ai të jetë burrërisht i vetëdijshëm për vështirësitë që e shqetësojnë dhe të jetë i gatshëm të përballet me to. Fashizmi e koncepton jetën si një luftë, në të cilën njeriu i duhet të fitojë një vend të denjë, para së gjithash duke e përshtatur veten (fizikisht, moralisht, intelektualisht) për t'u bërë mjet i kërkuar për ta fituar atë. Si për individin, ashtu për kombin, dhe kështu për njerëzimin (4). Prandaj, vlera e lartë e kulturës në të gjitha format e saj (artistike, fetare, shkencore) (5) dhe rëndësia e jashtëzakonshme e arsimit. Prandaj edhe vlera thelbësore e punës, me të cilën njeriu vë nën kontroll natyrën dhe krijon botën njerëzore (ekonomike, politike, etike dhe intelektuale).

Ky konceptim pozitiv i jetës është padyshim një koncept etik. Investon të gjithë fushën e realitetit, si dhe aktivitetet njerëzore që e zotërojnë atë. Asnjë veprim nuk përjashtohet nga gjykimi moral; asnjë veprimtari nuk mund të zhvlerësohet nga vlera morale që u jep vlere të gjitha gjërave. Prandaj jeta, siç është konceptuar nga Fashisti, është serioze, e rreptë dhe fetare; të gjitha shfaqjet e saj janë gati në një botë të pandërprerë nga forcat morale që i nënshtrohen përgjegjësive shpirtërore. Fashisti e përmbuz një jetë "të lehtë" (6).

Konceptimi fashist i jetës është një koncept fetar (7), në të cilin njeriu shihet në marrëdhëniet e tij imanente me një ligj më të lartë, i pajisur me një vullnet objektiv do të kapërcejë individin dhe ta ngrejë atë në anëtarësimin e vetëdijshëm të një shoqërie shpirtërore. "Ata që nuk perceptojnë asgjë përtej konsideratave oportuniste në politikën fetare të regjimit Fashist nuk arrijnë të kuptojnë se Fashizmi nuk është vetëm një sistem qeverisjeje por gjithashtu dhe mbi të gjitha një sistem mendimi.

Në konceptimin fashist të historisë, njeriu është njeri vetëm në sajë të procesit shpirtëror në të cilin ai kontribuon si anëtar i familjes, grupit shoqëror, kombit dhe në funksionin e historisë në të cilën të gjitha kombet sjellin kontributin e tyre. Prandaj, vlera e madhe e traditës në arkiva, në gjuhë, në zakone, në rregullat e jetës shoqërore (8). Jashtë historisë njeriu është inekzistent. Fashizmi pra është në kundërshtim me të gjitha abstraksionet individualiste të bazuara në materializmin e shekullit të tetëmbëdhjetë; dhe është në kundërshtim me të gjitha utopitë dhe risitë e Jakobizmit. Nuk beson në mundësinë e "lumturisë" në tokë

siç është konceptuar nga literatura ekonomike e shekullit XVIII, dhe, për këtë arsye, kundërshton nocionin teologjik se në një kohë të ardhme familja njerëzore do të sigurojë një zgjidhje përfundimtare të të gjitha vështirësive të saj. Ky nocion bie ndesh me përvojën e cila na mëson se jeta është në fluks të vazhdueshëm dhe në proces evolucioni. Në politikë Fashizmi synon realizmin; në praktikë, ai dëshiron të merret vetëm me ato probleme që janë produkt spontan i kushteve historike dhe që gjejnë ose sygjerjnë zgjidhjet e tyre (9). Vetëm duke hyrë në procesin e realitetit dhe duke marrë në zotërim forcat në punë brenda tij, njeriu mund të veprojë mbi njeriun dhe mbi natyrën (10).

Koncepti anti-individualist, fashist i jetës thekson rëndësinë e shtetit dhe e pranon individin vetëm për sa kohë që interesat e tij përkojnë me ato të shtetit, i cili qëndron për ndërgjegjen dhe vullnetin universal të njeriut si një entitet historik (11). Fashizmi i kundërvihet liberalizmit klasik i cili lindi si një reagim ndaj absolutizmit dhe e rraskapiti funksionin e tij historik kur Shteti u bë shprehja e ndërgjegjes dhe vullnetit të njerëzve. Liberalizmi e mohoi shtetin në emër të individit; Fashizmi e ripohon.

Të drejtat e shtetit shprehin thelbin e vërtetë të individit (12). Dhe nëse liria është atributi i njerëzve të gjallë dhe jo i dembelëve abstraktë të shpikur nga liberalizmi individualist, atëherë Fashizmi qëndron për liri, dhe për lirinë e vetme që ia vlen të ketë, lirinë e shtetit dhe të individit brenda shtetit (13). Konceptimi Fashist i Shtetit është gjithëpërfshirës; jashtë tij nuk mund të ekzistojnë vlera njerëzore ose shpirtërore, aq më



pak të kenë vlerë. Kuptohet kështu, Fashizmi, është totalitar dhe Shteti Fashist -një sintezë dhe një njësi gjithëpërfshirëse- interpreton, zhvillon dhe fuqizon të gjith jetën e një populli (14).

Asnjë individ ose grup (parti politike, shoqata kulturore, sindikata ekonomike, klasa shoqërore) jashtë Shtetit (15). Fashizmi, pra, është kundër Socializmit për të cilin uniteti brenda Shtetit (i cili bashkon klasat në një realitet të vetëm ekonomik dhe etik) është i panjohur, dhe që nuk sheh në histori asgjë tjetër përveç luftës së klasave. Fashizmi gjithashtu i kundërvihet sindikalizmit si një armë klasore. Por kur futet brenda orbitës së Shtetit, Fashizmi njih nevojat reale që krijuan socializmin dhe sindikalizmin, duke i dhënë atyre për shkak të peshës në sistemin esnaf ose korporatës në të cilin interesat divergjente koordinohen dhe harmonizohen në unitetin e Shtetit (16).

Të grupuar sipas disa interesave të tyre, individët formojnë klasa; ato formojnë sindikata kur organizohen sipas aktiviteteve të tyre të ndryshme ekonomike; por para së gjithash ato formojnë shtetin, i cili nuk është thjesht çështje numrash, shumat e individëve që formojnë shumicën. Prandaj fashizmi është kundër asaj forme të demokracisë që barazon një komb me shumicën, duke e ulur atë në nivelin e numrit më të madh (17); por është forma më e pastër e demokracisë nëse kombi konsiderohet ashtu siç duhet të jetë nga pikëpamja e cilësisë sesa e sasisë, si ide, më e fuqishmja sepse më etike, më koherente, më e vërteta, duke u shprehur në një popull si ndërgjegjja dhe vullneti i të paktëve, nëse jo, me të vërtetë, i një, dhe që përfundon të shprehet në ndërgjegjen

dhe vullnetin e masës, të të gjithë grupit të formuar etnikisht nga kushtet natyrore dhe historike në një komb, duke përparuar, si një ndërgjegje dhe një vullnet, përgjatë vijës së njëjtë të zhvillimit dhe formimit shpirtëror (18). Jo një racë, as një rajon i përcaktuar gjeografikisht, por një popull, që përjetëson historikisht vetveten; një turmë e unifikuar nga një ide dhe e mbarsur me vullnetin për të jetuar, vullnetin për pushtet, vetëdijen, personalitetin (19).

Për aq sa mishërohet në një shtet, ky personalitet më i lartë bëhet komb. Nuk është kombi që gjeneron shtetin; ky është një koncept i vjetruar natyralist që ofroi një bazë për publicitetin e shekullit XIX në favor të qeverive kombëtare. Përkundrazi është shteti ai që krijon kombin, duke dhënë vullnet dhe rrjedhimisht jetë reale në një popull të vetëdijshëm për unitetin e tij moral.

E drejta për pavarësi kombëtare nuk lind nga ndonjë formë thjesht letrare dhe idealiste e vetëdijes; akoma më pak nga një situatë de facto pak a shumë pasive dhe e pavetëdijshme, por nga një vullnet aktiv, i vetëdijshëm, politik që shprehet në veprim dhe i gatshëm për të provuar të drejtat e tij. Shkurtimisht, kjo rrjedh nga ekzistenca, të paktën në krenarinë, e një Shteti. Në të vërtetë, është Shteti që, si shprehje e një vullneti etik universal, krijon të drejtën për pavarësi kombëtare (20).

Një komb, siç shprehet në shtet, është një entitet i gjallë, etik vetëm për aq sa është progresiv. Pasiviteti është vdekje. Prandaj, Shteti nuk është vetëm Autoriteti që qeveris dhe i jep formën ligjore dhe vlerën shpirtërore individuale, por është gjithashtu fuqia që e bën vullnetin e

tij të ndjehet dhe të respektohet përtej kufijve të tij, duke dhënë kështu prova praktike të karakterit universal të vendimeve të nevojshme për të siguruar zhvillimin e tij. Kjo nënkupton organizimin dhe zgjerimin, potencial nëse jo aktual. Kështu, Shteti e barazon veten me vullnetin e njeriut, zhvillimi i të cilit nuk mund të kontrollohet nga pengesat dhe që, duke arritur vetëshprehje, demonstroi pafundësinë e tij (21).

Shteti Fashist, si një shprehje më e lartë dhe më e fuqishme e personalitetit, është një forcë, por një forcë shpirtërore. Ai përmbledh të gjitha manifestimet e jetës morale dhe intelektuale të njeriut. Funksionet e tij nuk mund të kufizohen vetëm në ato të zbatimit të rendit dhe ruajtjes së paqes, siç e kishte doktrina liberale. Nuk është thjesht një paisje mekanike për përcaktimin e sferës brenda së cilës individi mund të ushtrojë siç duhet të drejtat e tij të supozuara. Shteti Fashist është një standard dhe rregull i sjelljes i pranuar nga brenda, një disiplinë e të gjithë personit; ajo përshkon vullnetin jo më pak se intelektin. Ai qëndron për një parim i cili bëhet motivi kryesor i njeriut si anëtar i shoqërisë së civilizuar, duke u zhytur thellë në personalitetin e tij; banon në zemrën e njeriut të veprimit dhe të mendimit, të artistit dhe të njeriut të shkencës: shpirti i shpirtit (22).

Fashizmi, me pak fjalë, nuk është vetëm një ligjdhënëse dhe themelues i institucioneve, por një edukues dhe një promovues i jetës shpirtërore. Ai synon të modifikojë jo vetëm format e jetës, por përmbajtjen e tyre - njeriun, karakterin e tij dhe besimin e tij. Për të arritur këtë qëllim, ai zbaton disiplinën dhe përdor autoritetin, duke hyrë në shpirt dhe duke sunduar me ndikim të padiskutueshëm. Prandaj ka zgjedhur si emblemë shkopinjtë e Liktorit, simbolin e unitetit, forcës dhe drejtësisë.

## **-DOKTRINA POLITIKE DHE SOCIALE-**

**N**ë marsin e largët të vitit 1919, duke folur përmes kolonave të Popolo d'Italia, unë thirra në Milano ndërhyrjet e mbijetuara që kishin ndërhyrë, të cilet më kishin ndjekur që nga akti themelues revoluconar i Fashizmit në janar të 1915. Nuk kisha në mendje asnjë program specifik doktrinar. Doktrina e vetme që unë kisha përvojë praktike ishte ajo e socializmit, nga 1903-04 deri në dimrin e 1914 -gati një dekadë. Përvoja ime ishte si një ndjekes dhe një udhëheqës -por nuk ishte një përvojë doktrinore. Doktrina ime gjatë asaj periudhe kishte qenë doktrina e veprimit. Një doktrinë uniformë, e pranuar botërisht e Socializmit nuk kishte ekzistuar që nga viti 1905, kur lëvizja revizioniste, e kryesuar nga Bernstein, u ngrit në Gjermani, i kundërvënë nga formimi, në sharrën e tendencave, i një lëvizje revolucionare të majtë, e cila në Itali kurrë nuk e la fushën e frazave, ndërsa, në rastin e socializmit rus, u bë parathënie e Bolshevizmit.

Reformizmi, revolucionarizmi, centrizmi, jehona e asaj terminologjie ka vdekur, ndërsa në lumin e madh të Fashizmit mund të gjurmohen rryma që e kishin burimin tek Sorel, Peguy, Lagardelle të Lëvizjes Socialiste, dhe në grupin e sindikalistit italian i cili nga viti 1904 deri në 1914 solli një shënim të ri në mjedisin socialist italian - i paralajmëruar dhe kloroformuar më parë duke kurvëruar me partinë e Giolitti- një shënim në *Pagine Libere* të Olivetti, *Lupa* të Oranos, Enrico Leone *Diviners Sociale*.

Kur lufta përfundoi në 1919, Socializmi, si një doktrinë, tashmë ishte i vdekur; vazhdoi të ekzistonte vetëm si inat, veçanërisht në Itali, ku shansi i saj i vetëm ishte nxitja e hakmarrjeve kundër burrave që kishin dashur luftën dhe që do të detyroheshin të paguanin për të.

Popolo d'Italia e përshkroi veten në nëntitullin e saj si organi ditor i luftëtarëve dhe prodhuesve. Fjala prodhues ishte tashmë shprehja e një trendi mendor. Fashizmi nuk ishte foshnja e një doktrine të hartuar më parë në një tavolinë; ajo lindi nga nevoja e veprimit dhe ishte veprim; nuk ishte një parti por, në dy vitet e para, një anti-parti dhe një lëvizje. Emri që i dhashë organizatës fiksoi karakterin e saj.

Sidoqoftë, nëse ndokush kujdeset të rilevojë fletët tani të thërrmuara të atyre ditëve duke dhënë një llogari të takimit në të cilin u themelua *Fasci di combattimento*, ai nuk do të gjejë një doktrinë, por një seri pikash, parashikimesh, të të kuptohet se, kur u çliruan nga matrica e pashmangshme e paparashikimeve, duhej të zhvilloheshin brenda një periudhe disa vjeçare në një seri pozicionesh doktrimore që i jepnin të drejtë Fashizmit të renditej si një doktrinë politike që ndryshon nga të gjitha të tjerat, të kaluara ose të tashmet.

“Nëse borgjezia - thashë atëherë - beson se ka gjetur tek ne rrufe-përçuesit e tyre, ata gabojnë. Ne duhet të shkojmë drejt njerëzve...

Ne dëshirojmë që klasat punëtore të mësohen me përgjegjësitë e menaxhimit në mënyrë që ata të kuptojnë se nuk është çështje e lehtë për të drejtuar një biznes... Ne do të luftojmë si mbrojtës teknik ashtu edhe shpirtëror... Tani që trashëgimia e regjimit është e hapur, ne nuk

duhet të jemi të zyrtë. Ne duhet të nxitojmë përpara; nëse regjimi aktual do të zëvendësohet, ne duhet të zëmë vendin e tij. E drejta e trashëgimisë është e jona, sepse ne e nxitëm vendin të hynte në luftë dhe e çuam atë drejt fitores... Format ekzistuese të përfaqësimit politik nuk mund të na kënaqin; ne duam një përfaqësim të drejtpërdrejtë të disa interesave... Mund të kundërshtohet që ky program nënkupton një kthim tek esnafet (korporatat). S'ka rëndësi! Prandaj, shpresoj që kjo asamble të pranojë pretendimet ekonomike të përparuar nga sindikalizmi kombëtar...

A nuk është e çuditshme që nga dita e parë, në Piazza San Sepolcro, u shqiptua fjala "esnaf" (korporat), një fjalë e cila, ndërsa u zhvillua Revolucioni, do të shprehte një nga krijimet themelore legjislative dhe shoqërore të regjimit?

Vitet që i paraprinë Marshit në Romë mbulojnë një periudhë gjatë së cilës nevoja e veprimit ndalonte vonesat dhe përpunimet e kujdesshme doktrimore. Luftimet po zhvilloheshin në qytete dhe fshatra. Kishte diskutime por... kishte diçka - më të shenjtë dhe më të rëndësishme ... vdekja... Fashistët dinin të vdisnin. Një doktrinë - e përpunuar plotësisht, e ndarë në kapituj dhe paragrafë me shënime, mund të ketë munguar, por ajo u zëvendësua nga diçka shumë më vendimtare, - nga një besim. E njëjta gjë, nëse me ndihmën e librave, artikujve, rezolutave të miratuara në kongrese, fjalime madhore dhe të vogla, dikush duhet të kujdeset për të ringjallur kujtesën e atyre ditëve, ai do të zbulojë, me kusht që të dijë të kërkojë dhe të zgjedhë, se themelet doktrimore u hodhën ndërkohë që beteja ishte ende e ndezur. Në të vërtetë, ishte gjatë

atyre viteve që Fashisti mendoi i armatosur, u rafinua dhe vazhdoi përpara me organizimin e tij. Problemet e individit dhe shtetit; problemet e autoritetit dhe lirisë; u diskutuan problemet politike, sociale dhe, veçanërisht, ato kombëtare; konflikti me doktrinat liberale, demokratike, socialiste, masonike dhe me ato të Partito Popolare, u zhvillua në të njëjtën kohë me ekspeditat ndëshkuese. Sidoqoftë, mungesa e një sistemi zyrtar u përdor nga kundërshtarët e paqartë si një argument për të shpallur Fashizmin të paaftë për të përpunuar një doktrinë në kohën kur po formulohej ajo doktrinë -pa marrë parasysh trazirat, - së pari, siç është rasti me të gjitha idetë e reja, në maskën e mohimeve të dhunshme dogmatike; pastaj me petkun më pozitiv të teorive konstruktive, të inkorporuara më pas, në 1926, 1927 dhe 1928, në ligjet dhe institucionet e regjimit.

Fashizmi tani përcaktohet qartë jo vetëm si një regjim por si një doktrinë. Kjo do të thotë që Fashizmi, duke ushtruar aftësitë e tij kritike mbi vete dhe mbi të tjerët, ka studiuar nga këndvështrimi i tij i veçantë dhe gjykuar nga standardet e veta të gjitha problemet që prekin interesat materiale dhe intelektuale duke shkaktuar një shqetësim kaq të rëndë për kombet e botës, dhe është i gatshëm t'i trajtojë ato përmes politikave të veta.

Para së gjithash, në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të njerëzimit dhe mjaft larg nga të gjitha konsideratat e tanishme politike. Fashizmi, në përgjithësi, nuk beson në mundësinë ose dobinë e paqes së përhershme.

Prandaj, ai e hedh pas pacifizmin si një mantel për heqjen dorë nga shtrembërimi frikacak, në kundërshtim me vetësakrificimin.

Vetëm lufta çon të gjitha energjitë njerëzore në tensionin e tyre maksimal dhe u vë vulën e fisnikërisë atyre popujve që kanë guximin ta përballojnë atë. Të gjitha testet e tjera janë zëvendësues që kurrë nuk e vendosin një njeri ballë për ballë me veten para alternativës së jetës ose vdekjes. Prandaj, të gjitha doktrinat që shpallin pagën me çdo kusht janë të papajtueshme me Fashizmin. Po aq e huaj për frymën e Fashizmit, edhe nëse pranohet si e dobishme në përmbushjen e situatave të veçanta politike- janë të gjitha superstrukturat internacionaliste ose të Lidhjes të cilat, siç tregon historia, shkërmoqen përtokë sa herë që zemra e kombeve trazohet thellë nga konsiderata sentimentale, idealiste ose praktike. Fashizmi mbart këtë qëndrim anti-pacifist në jetën e individit. "Nuk më intereson fare" (*me ne frego*) - motoja krenare e skuadrave luftarake të skalitura nga një i plagosur në fashat e tij, nuk është vetëm një akt i stoicizmit filozofik, ajo përmbledh një doktrinë e cila nuk është thjesht politike: është dëshmi e një shpirti luftarak që pranon të gjitha rreziqet. Nënkupton një stil të ri të jetës italiane. Fashisti e pranon dhe e do jetën; ai e refuzon dhe e përçmon vetëvrasjen si veprim frikacakësh. Jeta, siç e kupton ai, do të thotë detyrë, ngritje, pushtim; jeta duhet të jetë e lartë dhe e plotë, ajo duhet të jetuar për veten, por mbi të gjitha për të tjerët, si për afër dhe larg, të tashmen dhe të ardhmen.

Politikat e regjimit për popullsinë janë pasojë e këtyre parimeve bazë. Fashisti e do fqinjën e tij, por fjala fqinj "nuk qëndron për ndonjë



konceptim të paqartë dhe të pazbulueshëm. Dashuria për të afërmin nuk përjashton ashpërsinë e nevojshme arsimore; akoma, më pak përjashton dallimet dhe gradën. Fashizmi nuk do të ketë asnjë lidhje me përqafimet universale; si anëtar i bashkësisë së kombeve i shikon popujt e tjerë drejt në sy; është vigjilent dhe në roje; ndjek të tjerët në të gjitha shfaqjet e tyre dhe vëren çdo ndryshim në interesin e tyre dhe nuk lejon që vetvetiu të mashtrohet nga paraqitjet e paqëndrueshme dhe të gabuara.

Një konceptim i tillë i jetës e bën Fashizmin mohimin e patundur ndaj doktrinës që qëndron në themel të të ashtuquajturit socializëm shkencor dhe Marksist, doktrina e materializmit historik që do të shpjegonte historinë e njerëzimit sipas luftës së klasave dhe ndryshimeve në proceset dhe instrumentet e prodhimit, deri në përjashtimin e çdo gjëje tjetër.

Fakti se peripecitë e jetës ekonomike —zbulimet e materialeve bazë, proceseve të reja teknike, dhe shpikjeve shkencore — kanë rëndësinë e tyre, asnjë se mohon; por që ato mjaftojnë për të shpjeguar historinë e njerëzimit deri në përjashtimin e faktorëve të tjerë është absurde. Fashizmi beson tani dhe gjithmonë tek shenjtërimi dhe heroizmi, si të thuash, i veprimeve apo akteve në të cilën asnjë motiv ekonomik, i largët apo i menjëhershëm, është shkak. Duke mohuar materializmin historik, i cili i sheh njerëzit thjesht si kukulla në sipërfaqen e historisë, dukë u shfaqur dhe duke u zhdukur në kreshtën e valëve ndërkohë që në thellësi, forcat që drejtojnë realisht, lëvizin dhe punojnë. Fashizmi

gjithashtu mohon karakterin e pandryshueshëm dhe të pariparueshëm të luftës së klasave që është përfundimi natyral i këtij konceptimi ekonomik të historisë: mbi të gjitha mohon idenë se lufta e klasave është agjenti pararendës në transformimet shoqërore. Pra, duke goditur tek dy nga pikat kryesore të doktrinës së socializmit, ajo çka mbetet prej tij është aspirata sentimentale, të vjetra sa njerëzimi vetë, drejt marrëdhënieve shoqërore në të cilat vuajtjet dhe dëshpërimet e popullit të thjeshtë do të lehtësohen. Por prapë edhe këtu Fashizmi e refuzon interpretimin ekonomik të lumturisë si diçka që sigurohet nga ana kolektive, pothuajse automatikisht, në një stad të caktuar të evolucionit ekonomik kur gjithkujt do t'i sigurohet maksimumi i mbështëtjës materiale. Fashizmi e eliminon mundësinë e konceptimit materialist të lumturisë, dhe e braktis këtë ide dhe ia lë ekonomistëve të mesit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Kjo do të thotë se Fashizmi e mohon ekuacionin: mirëqenie = lumturi, që i konsideron njerëzit kafshë, të lumtur dhe të kënaqur kur janë të ushqyer dhe të majmur, duke e reduktuar ekzistencën e tyre si vegjetative të pastër dhe të thjeshtë.

Pas socializmit, Fashizmi vë në shënjestër të gjithë bllokun e ideologjive demokratike dhe hedh poshtë si premisat e tyre, ashtu edhe aplikimet dhe zbatimet e tyre praktike. Fashizmi mohon se numrat, si të tillë, mund të jenë faktori përcaktues në shoqërinë njerëzore; mohon të drejtën e numravë të qeverisin sipas konsultimeve periodike; pohon pabarazinë e pariparueshme dhe pjellore dhe dobiprurëse të njerëzve që nuk mund të nivelohen nga asnjë mjet mekanik apo të jashtëm si e drejtë vote universale. Regjimet demokratike mund të përshkruhen si ato regjime në

të cilat njerëzit janë, herë pas here të mashtruar, duke besuar se ushtrojnë sovranitet, ndërsa gjatë gjithë kohës sovraniteti i vërtetë qëndron dhe ushtrohet nga të tjerë dhe ndonjëherë forca të papërgjegjshme dhe të fshehta. Demokracia është një regjim pa mbret, e infektuar nga shumë mbretër të cilët ndonjëherë janë më përjashtues, tiranë dhe shkatërrues sësa një, edhe nëse ai të jëtë një mbret mizor. Kjo shpjegon përse Fashizmi, megjithëse, për arsye kontigjente, ishte prirje republikane përpara 1922-shit -e braktisi atë qëndrim përpara Marshimit të Romës, duke qenë i bindur se forma e qeverisjes nuk ka më një rëndësi parësore dhe sepse studimi i monarkive të së shkuarës dhe të tashmes dhe republikave të së shkuarës dhe së tashmes tregojnë se asnjëra, si republikë as monarki nuk mund të gjykohej *sub specie aeternitatis* (nga një perspektivë universale), por secila qëndron si formë e një qeverie që shpreh evolucionin politik, historinë, traditat dhe psikologjinë e një vendi të caktuar.

Fashizmi e ka kapërcyer dilemën: monarki apo republikë, ku regjimet demokratike u endën për shumë kohë, duke i atribuar të gjithë pamjaftueshmëritë e së parës dhe duke e cilësuar të dytën si një regjim të perfeksionit, ndërkohë që eksperiencia na mëson se disa republika janë natyrshëm reaksionare dhe absolutiste ndërkohë që disa monarki pranojnë eksperimentet shoqërore dhe politike nga më të guximshmet.

Në një nga meditimet e tij filozofike, Renan, i cili kishte intuita parafashiste thotë: "Arsyeja dhe shkenca janë produktet e njerëzimit, por është kimerike ta kërkosh arsyen për njerëzit përmes njerëzve. Nuk është

thelbësore për ekzistencën e arsyes që të gjithë duhet ta njohin atë; edhe sikur të gjithëve do t'u duhej të fillonin, kjo nuk do të mund të arrihej nëpërmjet demokracisë e cila duket e destinuar të çojë në shfarosjen e të gjithë formave të veçanta të kulturës dhe të gjithë formave të të mësuarit. Parimi se shoqëria ekziston vetëm për mireqenien dhe lirinë e individëve që e përbëjnë atë nuk duket të përputhet me planet e natyrës, që kujdeset vetëm për speciet dhe e konsideron primare rezervimin e tyre duke qenë e gatshme të sakrifikojë individin që specia të ecë para. Duhet frikësuar shumë se fjala e fundit e demokracisë e kuptuar kështu (dhe më lejoni të ngutem të shtoj se është e ndjeshme ndaj një interpretimi tjetër) do të ishte një formë e shoqërisë ku një masë e degjeneruar nuk do t'i shkonte mendja më tej se sa të shijonin kënaqësitë vulgare të jo të ndershmes”.

Duke refuzuar demokracinë, Fashizmi refuzon gënjeshtren absurde konvencionale të barazisë politike, prirjen të papërgjegjësia kolektive, mitin e lumturisë dhe progresit të pakufishëm dhe të papërcaktuar. Por nëse demokracia kuptohet si një regjim në të cilin masat nuk zbrapsen në skajet e kornizës së Shtetit, atëherë shkrimtari i këtyre faqeve e ka përcaktuar dhe përkufizuar që tani Fashizmin si një demokraci të organizuar, të centralizuar dhe autoritare.

Fashizmi është përfundimisht dhe absolutisht e kundërta e doktrina të liberalizmit. Si në sferën politike, ashtu edhe në sferën ekonomike. Rëndësia e liberalizmit në shekullin XIX nuk duhet të ekzagjerohet për qëllime polemike të ditëve të sotme, as ne nuk duhet ta bëjmë një nga

shumë doktrinat që lulëzuan në atë shekull, një fe për njerëzimin për të tashmen dhe kohëve që do të vijnë. Liberalizmi lulëzoi realisht vetëm për pesëmbëdhjetë vite. Lindi më 1830-ën si një reagim kundër Holy Alliance (Aleanca e Shenjtë) e cila u përpoq të detyronte Europën të zmbropsej para 1789-ës; arriti kulmin më 1848-ën kur vetë Papa Pius i IX ishte liberal. Rënia filloi menjëherë pas atij viti. Nëse 1848-a ishte një vit drite dhe poezie, 1849-a ishte një vit errësire dhe tragjedi. Republika Romake u vra nga një republikë simotër, ajo e Francës. Në të njejtin vit Marks, me të famshmin Communist Manifesto (Manifesti Komunist), hodhi dhe ungjillin e socializmit.

Më 1851 Napoleoni III organizoi grushtin e shtetit joliberal dhe e drejtoi Francën deri më 1870-ën kur u largua nga një kryengritje popullore pas një prej disfatave më të mëdha ushtarake të njohura në histori. Fitimtari ishte Bismarck-u i cili as nuk i kishte njohur ndonjëherë vendndodhjen e liberalizmit apo profetët e tij. Është tregues fakti se përgjatë shekullit XIX feja e liberalizmit ishte plotësisht e panjohur për njerëz aq të civilizuar sa ishin gjermanët, por përjashtim bën vetëm ajo që përshkruhet si “parlamenti qesharak i Frankfurtit” që zgjati veç një vit. Gjermania e fitoi bashkimin kombëtar jashtë liberalizmit dhe në kundërshti me liberalizmin, një doktrinë që duket të jetë e huaj për temperamentin gjerman, në thelb monarkik, ndërkohë që liberalizmi është pararendësi historik dhe logjik i anarkisë. Tre fazat e formimit të bashkimit gjerman ishin tre luftërat e 1864-ës, 1866-ës, dhe 1870-ës, të drejtuara nga “liberalë” të tillë si Moltke dhe Bismarck. Dhe në formimin e bashkimit të Italisë liberalizmi luajti një rol farë të pakët kur

krahasohet me kontributin e bërë nga Mazzini dhe Garibaldi të cilët nuk ishin liberalë. Por për ndërhyrjen e joliberalit Napoleon i III ne nuk duhet të kishim Lombardinë, dhe pa ndihmën e joliberalit Bismarck në Sadowa dhe në Sedan me shumë mundësi ne nuk duhet të kishim Venecian më 1866-ën dhe më 1870-ën ne nuk duhet të kishim hyrë në Romë. Vitet që pasuan nga 1870-a në 1915-ën mbulojnë një periudhë që shënoi, edhe në mendimin e klerikëve të kredos së re, perëndimin e fesë së tyre, e sulmuar nga dekadentizmi në literaturë dhe nga aktivizmi në praktikë. Aktivizëm: mënyrë për të thënë nacionalizëm, futurizëm, fashizëm.

Tani liberalizmi po përgatitet të mbyllë dyert e tempujve të tij, e shkretuar nga njerëzit të cilët ndjejnë se agnosticizmi që shprehte në sferën e ekonomisë dhe indiferentizmi i cili ka dhënë prova në sferën e politikës dhe të moralit, do të çonte botën në gjërmadha në të ardhmen siç ka bërë në të shkuarën.

Kjo shpjegon përse të gjithë eksperimentet politike të ditëve të sotme janë anti-liberale, dhe është jashtëzakonisht qesharake të përpiqesh mbi këtë gjë duke i vendosur në anën e zbehtë të historisë, sikur historia të ishte një konservë e veçuar për liberalizmin dhe; sikur liberalizmi të ishte fjala e fundit e civilizimit përtej së cilës askush nuk mund të shkojë.

Mohimi Fashist i socializmit, demokracisë, liberalizmit, nuk duhet, gjithsesi, të interpretohet sikur nënkupton një dëshirë të kalimit në pozicionet e botës para vitit 1789, një vit që shpesh referohet si viti që

hapi shekullin demo-liberal. Historia nuk udhëton prapa. Doktrina Fashiste nuk e ka marrë De Maistre si profetin e tij. Absolutizmi monarkik është i së shkuarës, po ashtu është edhe kishtaria (dedikimi i tepërt për institucionin kishtar më tepër sesa për fenë së cilës institucioni i shërben). Të vdekura dhe të mbaruara janë edhe privilegjet feudale dhe ndarja e shoqërisë në kasta të mbyllura dhe të pakomunikueshme. As konceptimi Fashist i autoritetit s'ka asgjë të përbashkët me një Shtet të drejtuar nga policia.

Një parti që qeveris një komb “totalitarisht” është një pikënisje e re në histori. Nuk ka as pika referimi as krahasimi. Nga poshtë gjermadhavë të doktrinave liberale, socialiste, dhe demokratike, Fashizmi nxjerr ato elementë që janë akoma të gjalla. Ruan ato që mund të përshkruhen si “fakte të fituara dhe të mësuara” të historisë; refuzon të gjitha të tjerat. Kjo për të thënë, refuzon idenë e një doktrine të përshtatshme posaçërisht për të gjitha kohërat dhe të gjithë njerëzit. Duke parë se shekulli XIX ishte shekulli i socializmit, liberalizmit, demokracisë, kjo nuk do të thotë se shekulli i XX-ë duhet të jetë gjithashtu shekulli i socializmit, liberalizmit apo demokracisë. Doktrinat politike kalojnë; kombet qëndrojnë. Jemi të lirë të besojmë se ky është shekulli i autoritetit, një shekull që ka tendencën nga e “djathta”, një shekull Fashist. Nëse shekulli XIX ishte shekulli i individit (liberalizmi nënkupton individualizmin) jemi të lirë të besojmë se ky është shekulli “kolektiv”, dhe si pasojë shekulli i Shtetit. Është mjaft logjike për një doktrinë të re të fusë në përdorim elemente mjaft të gjalla dhe të dobishme të doktrinave të tjera. Asnjë doktrinë nuk ka lindur plotësisht e re dhe e

